

## K O N T R A T E

### M I D I S

Arta Miçi, lindur me 1949, banuese ne Tirane, Rruga "Muhamet Gjolllesha", Pall.48, ap.5, dhe Aleksandros Dusias, lindur me 1950, banues ne Athine, ne rrugen Panoriti nr.8 , te cilet rane dakort per sa me poshte:

#### Neni 1

Te themelojne nje shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar , per te ushtruar veprimtari private e quajtur:

"ARAL" SH.P.K.

Kjo shoqeri do t'a kete seline e saj ne Shqiperi ne Tirane ne rrugen Muhamet Gjolllesha, pallati 48, apartamenti 5, do te ushtroje veprimtarine e saj per nje periudhe prej 49 (dyzetente) vjet.

#### Neni 2

Sipas legjislacionit shqiptar, shoqeria tregtare "Aral " Sh.P.K. është person juridik shqiptar dhe aktiviteti i saj rregullohet nga normat qe permbahen ne kete kontrate, nga statuti i saj dhe nga ligji 7638 i dates 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare". Statuti i shoqerise i bashkelidhet kesaj kontrate dhe eshte pjese e pandare e saj.

Ortaket e shoqerise pergjigjen vetem per detyrimet e tyre.

#### Neni 3

##### OBJEKTI I SHOQERISE

Shoqeria mund te krijojë seli, filiale, perfaqesi dhe agjensi ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte ketij territori.

Objekti i shoqerise eshte:

INDUSTRI, TURIZEM, BUJQESI, ARTIZANAT, USHQIMORE, IMPORT-EXPORT, TRANSPORT DETAR, AJROR DHE TOKESOR SI DHE NDERMARRJE PRODHUESE.

#### Neni 4

KAPITALI BAZE I SHOQERISE TREGTARE " ARAL " Sh.P.K.

Kapitali baze i shoqerise eshte leke.

Kapitali baze i shoqerise eshte ndare sipas ketyre kuotave:

1. Arta Miçi nga 1 deri 50 pjese.

2. Aleksandros Dusias nga 51 deri 100 pjese.

#### Neni 5

Kapitali baze i shoqerise, sipas nenit 4 te kesaj kontrate, perfaqeson , kapitalet e derdhura nga ortaket te nevojshme per veprimtarine e shoqerise. Sipas kerkeses se ligjes

kapitali fillestar do te derdhet ne Banken Tregtare ose ne nje nga bankat e tjera te njohura nga Shteti Shqiptar.  
Ne librin e llogarise se shoqerise krijohet "kapitali shoqeror",ku shenohet kapitali i derdhur nga çdo ortak.  
Rritja e kontributit te ortakëve nuk eshte e kufizuar.

#### Neni 6

Shoqeria e fillon aktivitetin e saj pasi te kete marre autorizimin nga organet kompetente shteterore.  
Shoqeria e pushon aktivitetin e saj me 31 dhjetor 2042.  
Fitimi i realizuar nga shoqeria ,pas shlyerjes se borxheve qe behet me mbylljen e bilancit te çdo viti dhe terheqjen e fondeve te tjera,do t'i nenshtrohet pagimit te taksave te percaktuar nga Ministria e Financave e Republikës se Shqiperise ne baze te legjislacionit shqiptar.  
Fitimi qe mbetet do te ndahet proporcionalisht sipas kuotave te seicilit nga ortakët ne kapitalin baze te shoqerise.I konvertuar ne valute ai mund te trasferohet jashte shtetit pa asnje pengese.  
**OBLIGIMET E ORTAKEVE NE LIDHJE ME CDO INISIAIVE TE VECANTE DO TE SAKTESOHEN ME AKTE TE VECANTA QE DO T'I BASHKANGJITEN KESAJ KONTRATE.**

#### Neni 7

Organet e shoqerise jane:

- Asamblea e ortakëve;
- Administratori;

Modalitetet per perberjen dhe funksionimin e organeve te mesiperme percaktohen nga statuti i shoqerise.

#### Neni 8

Ortakët jane te detyruar te ruajne sekretin e dokumentacionit,informacioneve,njohjeve dhe te eksperiences te kembyer e te realizuar brenda shoqerise dhe te marrin te gjitha masat per te evituar perhapjen e tyre qofte edhe te pjeseshme.  
Ortakët jane pergjegjes per pasojat e demshme te nje shkeljeje te tille te mundeshme,kur kjo vjen si pasoje e nje veprimi te qellimshem ose nenvleftesimi.

#### Neni 9

##### VLEFUSHMERIA E KONTRATES

Kjo kontrate eshte e vlefshme per 49 vjet.Ortakët kane te drejte te heqin dore nga kjo kontrate,duke lajmeruar nje vit me pare.  
Lajmerimi behet me shkrim.

#### Neni 10

Zgjidhja e mosmarreveshjeve midis ortakëve do te behet konform normave dhe konventave nderkombetare per rregullimin e mosmarreveshjeve ne shoqerite tregtare ne Gjykaten e Rrethit Tirane ose ne nje gjykate nderkombetare.

#### Neni 11

dispozitat me te detajuara per shoqerine jane percaktuar dhe  
permbahen ne statut.

Neni 12

Kjo kontrate eshte e vlefshme qysh ne momentin e nenshkrimt nga  
ortaket te cilet nenshkruan para noterit me vullnetin e tyre te  
lire.

Ortaket

Arta Miçi

Aleksandros Dusias

TIRANE, me

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E DREJTESISE  
NOTERIA

Nr. 1410 rep.  
Nr. 693 kol.

VERTETIM

Sot me date 20/1/94 ne zyren e noterise ne Tirane u paraqiten  
personalisht meje noteres  
, Arta Miçi dhe Aleksandros Dusias per  
te cileve u vura ne dijeni nga leternjoftimet e  
tyre, madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar, te  
cilet me deklaruan se kete Kontrate e kane redaktuar jashte kesaj  
zyre, pasi e lexuan e nenshkruan rregullisht, ç'ka e vertetoj une  
si notere me nenshkrimin tim.



NOTERE  
Schpresa Zekeria



## STATUT

### SHOQERISE TREGTARE "ARAL" SH.P.K.

Shoqëria Tregtare ARAL sh.p.k, është formuar mbi bazën e kontratës së nënshkruar nga Arta Miçi dhe Aleksandros Dusias. Ata kanë rënë dakort për të hartuar këtë statut, si më poshtë:

#### KAPITULLI 1 NORMA TE PERGJITHSHME

##### Neni 1

Emertimi i i shoqërisë tregtare është ARAL Sh.p.k (Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar). Shoqëria është person juridik shqiptar.

Shoqëria fiton dhe gëzon të drejtat e një personi juridik nga data e regjistrimit të saj në Gjykatë.

##### Neni 2

Shoqëria zhvillon dhe ushtron aktivitetin e saj konform ligjeve shqiptare dhe nënve të hartuara në dokumentat e formimit të saj (kontrata dhe statuti)

##### Neni 3

Shoqëria është formuar për qëllimin e parashikuar nga objekti shoqëror dhe veprimtaria e saj rregullohet sipas ligjit 7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

##### Neni 4

Objekti shoqëror i shoqërisë "ARAL" Sh.p.k. është: INDUSTRI, TURIZEM, BUJQESI, ARTIZANAT, USHQIMORE IMPORT-EXPORT, TRANSPORT DETAR, AJROR DHE TOKESOR SI DHE NDERMARRJE PRODHUESE.

##### Neni 5

Shoqëria e ka selinë e saj në Shqipëri, në Tiranë, Rruga "Muhamet Gjollësia", Pallati 48, Apartamenti 5. Shoqëria mund të ngrejë ose të shkrijë filiale dhe perfaqësi në qytete të tjera të Shqipërisë ose në vende jashtë këtij territori. Të gjitha këto njësi të shoqërisë krijohen dhe veprojnë konform legjisllacionit shqiptar dhe të vendeve ku do të hapen.

##### Neni 6

Kapitali baze i shoqërisë është leke.

#### KAPITULLI 2 TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKEVE

##### Neni 7

Ortakët gëzojnë këto të drejta :

- Administrimin e aktivitetit të shoqërisë konform kontratës dhe statutit.
- Pjesëmarrja në rezultatet e aktivitetit të shoqërisë në çdo formë të parashikuar nga kontrata dhe statuti.
- Pjesëmarrjen, me anën e perfaqësuesve në të gjitha organet e shoqërisë.
- Shohin të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me situacionin ekonomik-tregtar dhe aktivitetet e shoqërisë, si dhe të gjitha dokumentave të trajtuara nga ndërmarrja si bilanci dhe llogaritë ekonomike.
- Bëjnë propozime të reja që paraqiten për t'u shqyrtuar nga Asambleja e Ortakëve. - Terhiqen nga shoqëria duke afruar kuotat e

të, sipas çmimit që ata deshirojnë në favor të paleve të tjera. Çmimi i shitjes së kuotave shoqërore të atij që terhiqet nuk mund të jetë më e vogël nga ajo e ofruar nga Ortaket.

#### Neni 8

Detyrimet kryesore të Ortakeve janë:

- të depozitohen kuotat e tyre fillestare si dhe ato suplementare, sipas kontratës dhe statutit; në rast shtimi të kapitalit shoqëror derdhja e kuotave do të kërkojë nga Administratoret në afatë dhe mënyra të pershtatshme.
- të marrin pjesë në administrimin e shoqërisë me anë të organeve që krijojnë vetë ortaket;
- t'i japin shoqërisë çdo të dhënë esenciale për të arritur çdo qëllim që është lidhur me këto aktivitete.
- të kryejnë çdo detyrim për ekzekutimin e objektivave të parashikuara për funksionimin e shoqërisë..

#### Neni 9

Seicili nga ortaket ka të drejten të terhiqet nga shoqëria duke paraqitur vendimin për këtë në asamblenë e ortakeve me pare duke respektuar ç'ka është parashikuar në nenin 7.

Terheqja eventuale nuk e çliron këtë ortak nga detyrimet që ka ndaj shoqërisë dhe nuk nderpret detyrimet që ka ndaj ortakeve të tjera. Nëse këta të fundit refuzojnë marrjen e kuotave të ortakut që terhiqet, ky, pasi kanë kaluar tridhjetë ditë nga njoftimi i terheqjes, e shet pjesën e tij të tretëve, por jo më çmim më të ulët se ai i ofruar nga ortaket e tij.

### KAPITULLI III KUSHTET EKONOMIKE

#### Neni 10

Aktiviteti i shoqërisë realizohet në mbështetje të leverdisë ekonomike dhe pasqyrohet nga bilançet e saj.

#### Neni 11

Ortaket marrin pjesë në formimin e kapitalit baze me anën e kuotave të tyre, që fiksohen në kontratën e themelimit të ndërrmarrjes.

Mënyrat dhe afatet e derdhjes së kuotave të kapitalit baze përcaktohen nga Asamblea e Ortakeve.

#### Neni 12

Ortaku që nuk ka derdhur kuotën e tij për kapitalin baze të shoqërisë brenda afatëve, kuotes së tij të parashikuar është i detyruar t'i shtojë çdo ditë një shumë prej 1% të shumës së detyruar.

#### Neni 13

Kur shoqëria pushon aktivitetin e saj, pasi ka shlyer borxhet, u ndan ortakeve pjesën e mbetur të kapitalit dhe të fitimit, proporcionalisht me kuotat e seicilit për formimin e kapitalit baze të shoqërisë.

#### Neni 14

Shoqëria është pronare e pasurisë së saj duke patur të drejten për t'a patur dhe përdorur këtë pasuri sipas qëllimit dhe objektivit të aktivitetit që kryen.

Shoqëria gëzon të drejtat për mbrojtjen e përfitimeve të saj konform legjisllacionit shqiptar.

#### Neni 15

Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fonde të tjera specifike

financimi (per ecjen e zhvillimit te saj, per nxitjen e rritjes ekonomike etj).

Perberja,entiteti,burimet per krijimin e fondit rezerve,perdorimi dhe rregullat e çdo fondi specifik vendosen nga Asamblea e Ortakeve.

Shoqeria disponon plotesisht mjetet e saj financiare.

Borxhet qe lindin gjate ushtrimit te veprimtarise se saj mbulohen nga fondi rezerve dhe nga fondet e tjera ose nga shumet suplementare qe mund te derdhen nga ortaket nese fondet egzistues nuk mjaftojne per te mbuluar borxhet.

#### Neni 16

Fitimi neto i shoqerise,pas derdhjes se shumave per amortizimin e te gjitha pasurive te tundshme e te patundshme sipas keseteve te percaktuara,te kuotave relative te kredive per investimet,shpenzimeve per personelin,per lendet e para dhe ndihmese,per energjine,per shpenzimet e pergjithshme si dhe per shpenzimet e tjera per aktivitetin prodhues dhe jo prodhues, ndahet midis ortakeve çdo vit proporcionalisht sipas kuotave te tyre ne kapitalin baze te ndermarjes.

#### Neni 17

Vleresimi i te mirave te shoqerise ne bilançet e saj shprehet ne monedhe shqiptare dhe te huaj,sipas normave ligjore te aplikueshme ne Shqiperi.

Bilançi vjetor duhet te hartohet e te mbyllet brenda dates 31 mars te vitit pasardhes.

Bilanci vjetor mbeshtetet ne raportin e perpiluar nga ekspertet kontabel

Forma e bilanceve dhe llogarive ekonomike te shoqerise eshte kompetence e organit te saj administrativ.

#### Neni 18

Veprimtaria financiare mbeshtetet ne aktivin dhe pasivin qe detyrimisht pasqyrohen ne bilanc.

Llogaria kontabel dhe ajo ekonomike mbahen ne Shqiperi ku eshte selia e Shoqerise.

Rezultatet financiare te aktivitetit te shoqerise vendosen ne baze te te dhenave te bilançit vjetor.

### KAPITULLI IV ADMINISTRATA

#### Neni 19


Organi sovran i shoqerise eshte ASAMBLEA E ORTAKEVE.Ne te bejne pjese ortaket me te drejten e votes,sipas sasise se kapitalit baze te shoqerise.

Asamblea e ortakeve vendos me shumicen e ortakeve ose unanimisht per bilançin vjetor,modifikimet e statutit,per shtimin ose pakesimin e kapitalit baze te shoqerise,per emerimin e Administratorit ,per emerimin e ekspertit kontabel (ne se eshte e nevojshme),per nderprerjen e veprimtarise se shoqerise etj.

Asamblea e ortakeve vendos me shumice votash.

Asamblea e ortakeve mblidhet te pakten nje here ne vit,duke u njoftuar me shkrim tridhjete dite me pare.

Vendimet e saj te marra konform statutit dhe ligjit jane te detyrueshme per te gjitha ortaket,pervec te drejtes per te kundërshtuar vendime qe ata i konsiderojne te demshme,brenda tridhjete diteve.





#### Neni 20

Organi administrativ i shoqerise ,eshte Administratori i emeruar ne funksionet e tij nga asamblea e ortakëve, sipas propozimit te ortakëve.

Administratori qendron ne detyre per nje periudhe kohe jo me shume se tre vjet por mandati i tij mund te rinovohet. Detyrat Administratorit jane :

- te siguroje drejtimin e shoqerise;
- te perfaqesoje shoqerine ne raport me te tretet, brenda kufijve te objektit te veprimtarise se tij, me perjashtim te rasteve kur eshte kerkuar unanimiteti i ortakëve, ose qe hyjne ne kompetencat qe ky statut i atribuon asamblese se ortakëve;
- te siguroje zbatimin e drejte dhe te sakte te vendimeve te asamblese se ortakëve.
- organizon punen per realizimin e planeve te shoqerise dhe paraqet raportin per kete;
- brenda programeve dhe planeve te pergjithshme realizon administrimin e pasurise se shoqerise perfshire mjetet financiare, brenda kufijve te vendimeve te marra nga organi administrativ i ndermarrjes;
- drejton dhe kontrollon aktivitetin e filialeve dhe perfaqesive;
- perfaqeson shoqerine me te tretet perpara gjykatave dhe organeve te arbitrazhit, firmos kontratat ne emer dhe per llogari te shoqerise dhe siguron aplikimin e tyre;
- referon dhe pergjigjet para asamblese se ortakëve per ekzekutimin e veprimeve ne lidhje me aktivitetin e shoqerise si dhe per realizimin e objektivave dhe detyrave qe jane kompetence e tij.

#### Neni 21

Raportet e punes ne shoqeri dhe ne te gjitha varteset e saj rregullohen nga kontrata e punes. Per qeshtjet qe nuk jane te plota ne kontraten e punes, aplikohen format e parashikuara nga legjislacioni shqiptar per punen.

### KAPITULLI V MBYLLJA E SHOQERISE

#### Neni 22

Aktiviteti i shoqerise pushon me 31 dhjetor ose me pare, sipas propozimit te bere nga nje ortak, si dhe ne te gjitha rastet e parashikuara ne dokumentin e themelimit te ndermarrjes (kontrata). Shoqeria pushon se vepruari ose per t'u organizuar ose per t'u likuiduar.

#### Neni 23

Kur shoqeria likuidohet:

- Asamblea e Ortakëve emeron komisionin e likuidimit te cilit i paraqet bilançin e likuidimit dhe shoqeria e perfundon aktivitetin e saj ne momentin e aprovimit te ketij bilançi.
- te mirat qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejten e perdorimit per qellimet e saj i kthehen pronarit te tyre.
- mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise dhe te filialeve te saj dhe fondet financiare rindahen





midis antareve proporcionalisht me kuotat e tyre, pas shlyerjes se  
borxheve kreditoreve.

Neni 24

Ky statut eshte i vlefshem qe ne momentin e nenshkrimt nga te tre  
ortaket te cilet e nenshkruan rregullisht para noteres me  
vullnetin e tyre te lire.

Ortaket:

Arta Miçi

Aleksander Dusias

Tirane, me

1993.

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E DREJTESISE  
NOTERIA

Nr. 1411 Rep.  
Nr. 694 Kol.

VERTETIM

Sot me date \_\_\_\_\_, ne zyren e noterise ne Tirane u paraqiten  
personalisht \_\_\_\_\_ para \_\_\_\_\_ meje, noteres  
, Arta Miçi dhe Aleksandros Dusias, per identitetet e te cileve u  
vura ne dijeni nga leternjoftimet e tyre madhore e me zotesi te  
plate juridike per te vepruar, te cilet me deklaruan se kete  
Statut e kane redaktuar jashte kesaj zyre, pasi e lexuan e  
nenshkruan rregullisht, ç'ka e vertetoj une si notere me  
nenshkrimin tim.



NOTERE  
*Stjepan Zekin*